



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

Tiranë, 7 Prill 2026

**Subjekti:** Shqetësime mbi përputhshmërinë me standardet e BE-së në fushën e transportit dhe konkurrencës

**Drejtuar:** Ambasadorit të Bashkimit Europian, Sh.T.Z.Silvio Gonzato  
Ambasadorit të Republikës Federale Gjermane, Sh.T.Z. Karl Berger  
Ambasadorit të Mbretërisë së Holandës, Sh.T.Z. Reinout Vos

Të nderuar shkëlqesi,

Ju drejtohem në cilësinë time si Nënkryetare e Komisionit të Stabilizim-Asociimit në Kuvendin e Shqipërisë për të sjellë në vëmendjen tuaj një zhvillim legjislativ që është aktualisht në shqyrtim dhe që, sipas vlerësimit tim, ngre shqetësime të rëndësishme lidhur me përputhshmërinë me standardet e Bashkimit Europian dhe besueshmërinë e përpjekjeve të vazhdueshme reformuese në kuadër të procesit të integritimit.

Një amendim i propozuar në ligjin nr. 9710/2007 "Për portet turistike në Republikën e Shqipërisë" parashikon që portet turistike, kur janë pjesë e projekteve që marrin statusin "investim strategjik", mund të ndërtohen dhe operohen drejtpërdrejt nga investitori, jashtë procedurave standarde konkurruese apo koncesionare, ndërsa rregullat kryesore do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ndërsa promovimi i investimeve, veçanërisht në sektorin e turizmit, është një objektivi i ligjshëm dhe i rëndësishëm, kjo nismë ngre shqetësime lidhur me përputhshmërinë me parimet themelore të acquis të BE-së, si dhe me detyrimet që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.

Në veçanti, kuadri i propozuar duket se krijon përjashtime nga procedurat e hapura dhe konkurruese në dhënie të drejtave mbi infrastrukturën bregdetare dhe portuale. Kjo ngre shqetësime në raport me Kapitullin 5 (Prokurimi Publik) dhe Kapitullin 8 (Politika e Konkurrencës), ku transparenca, trajtimi i barabartë dhe konkurrenca e ndershme janë parime themelore. Dhënia e të drejtave ekskluzive për investitorë të përzgjedhur, pa procedura konkurruese, rrezikon të krijojë shtrembërime në treg dhe të minojë këto standarde.

Gjithashtu, një qasje e tillë ngre shqetësime në dritën e Nenit 71 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, i cili kërkon shmangien e masave që shtrembërojnë konkurrencën. Dhënia e të drejtave

ekskluzive për zhvillim dhe operim një subjekti të vetëm, jashtë konkurrencës, mund të krijojë avantazhe selektive dhe kushte të pabarabarta në treg.

Në vijim, propozimi ka rëndësi edhe në kontekstin e Kapitullit 14 (Politika e Transportit), pasi infrastruktura portuale përbën pjesë të sistemit të transportit. Në vendet e Bashkimit European, kjo infrastrukturë i nënshtrohet kuadrove të qarta rregullatore që garantojnë akses jo-diskriminues, transparencë dhe mbikëqyrje të duhur. Integrimi automatik i të drejtave për zhvillimin e porteve në kuadër të një investimi privat, pa procedura konkurruese, përbën një devijim nga këto parime.

Propozimi gjithashtu zbeh dallimin midis projekteve private dhe infrastrukturës publike. Në praktikën europiane, edhe kur projektet konsiderohen strategjike, infrastruktura portuale mbetet objekt i rregullimeve të veçanta, përmes koncesioneve, licencave apo procedurave konkurruese.

Po ashtu, projektligji parashikon një rol të zgjeruar të diskrecionit ekzekutiv, ku procedurat dhe kriteret kryesore do të përcaktohen përmes akteve nënligjore. Në kontekstin e reformave për shtetin e së drejtës dhe qeverisjen, kjo ngre shqetësime për transparencën, sigurinë juridike dhe mbikëqyrjen institucionale.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se qeveria shqiptare është zotuar më parë të rishikojë kuadrin ligjor për investimet strategjike, me synim forcimin e transparencës dhe përafrimin me standardet e BE-së. Në këtë kontekst, ky propozim duket se shkon në drejtim të kundërt, duke krijuar mospërputhje brenda vetë agjendës reformuese.

Gjithashtu, relacioni shpjegues i projektligjit thekson se ky propozim nuk synon përafrim të drejtpërdrejtë me acquis të BE-së. Në një fazë kur Shqipëria pritet të thellojë përafrimin dhe të demonstrojë progres konkret, kjo qasje rrezikon të dërgojë sinjale kontradiktore.

Në këto kushte, besoj se është e rëndësishme që kjo nismë të vlerësohet me kujdes në raport me standardet e BE-së dhe ndikimin e saj në procesin e integritimit.

Mbetem e angazhuar për të mbështetur reforma që forcojnë transparencën, konkurrencën dhe përafrimin me standardet europiane, dhe mirëpres çdo mundësi për dialog të mëtjshëm mbi këtë çështje.

Me respekt,

**Jorida TABAKU**

**Nënkryetare**

**Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asociimit**